

## INTERVISTË

## Weber: BE-ja s'kishte vullnet ta ndreqte EULEX-in

Fitim Gashi

PRISHTINË, QERSHOR – Bashkimi Evropian ka humbur shansin për ta ndrequr EULEX-in në vitin 2014, por ka dështuar ta bëjë këtë. Kështu ka thënë analisti politik pranë Këshillit Politik të Demokratizimit, Bodo Weber. Në intervistën dhënë “Kohës Ditore”, Weber ka potencuar se Brukseli i dha një transicion të rremë dhe mandat të thyer EULEX-it, pas vitit 2014 duke ndikuar që ky mision të përmbushë vetëm pjesërisht mandatin. Kjo është arsyeja kryesore për zhgënjimin e qytetarëve të Kosovës në EULEX, ka thënë gjermani Weber.

“Unë do të thosha se arritjet më të mëdha të këtij misioni janë në fushën e doganave dhe në punët e zakonshme të policisë”, ka thënë Weber. Para kësaj situatë, më e mira që mund të pritët nga vazhdimi i mandatit të misionit, sipas Weberit, është përfundimi i rasteve nga prokurorët dhe gjyqtarët evropianë, si dhe të ndihmohet transicioni i gjyqësorit në veri të Kosovës. Sa u përket institucioneve vendëse, Weber ka thënë se “definitivisht” ato nuk janë të gatshme t'i marrin të gjitha përgjegjësitë.

“Themelimi i Gjykatës Speciale është justifikuar pjesërisht nga pamundësia për të mbrojtur dëshmitarët brenda Kosovës. Dhe kjo pa dyshim flet për forcën e institucioneve të Kosovës”, ka theksuar ai.

## EULEX-i përmbushi pjesërisht misionin

**KD:** Z.Weber, si e vlerësoni punën e misionit të EULEX-it dhe sa ka përmbushur nga mandati për këto vite sa është në Kosovë? Në cilat fusha mendoni se janë arritjet më të mëdha?

**Weber:** EULEX-i është themeluar si misioni më ambicioz i Bashkimit Evropian në sundimin e ligjit, të cilit edhe i janë ngarkuar qëllime ambicioze. Por ky mision ka arritur të përmbushë vetëm një pjesë të këtyre objektivave. Nga njëra anë, kjo ka ndodhur për shkak të barrës së madhe dhe mungesës së unitetit brenda Bashkimit Evropian mbi çështjen e pavarësisë së Kosovës, në anën tjetër, sepse institucionet përgjegjëse që merren me mbikëqyrjen e EULEX-it në Bruksel janë tradicionalisht të dobëta në aspektin gjyqësor. Unë do të thosha se arritjet më të mëdha të këtij misioni janë në fushën e doganave dhe në punët e zakonshme të policisë, por duke përjashtuar më shumë politikisht çështjet e ndjeshme të cilat është dashur t'i trajtonte ky mision.

**KD:** Vetëm pak muaj para se t'i skadojë mandati, EULEX-i ndërmoi një aksion të gjerë duke arrestuar një “grup kriminal” i udhëhequr nga një deputet i Kuvendit të Kosovës dhe ish-epror i lartë i UÇK-së? Ky aksion a mund të ndërlihet me mandatin e misionit sa për ta arsyetuar veten?

**Weber:** Unë supozoj se kjo është më shumë rezultat i prokurorëve të EULEX-it, të cilët kanë qenë të vetëdijshëm se puna e misionit po përfundon në Kosovë, prandaj



**“Mes zgjidhjes që ta ndreqë EULEX-in ose ta mbyllë atë, Bashkimi Evropian nuk e bëri asnjëherë, por pasoi një mandat i thyer dhe një transicion i rremë. Prandaj, më e mira që mund të presim nga ky mision është përfundimi i disa rasteve të profilit të lartë nga prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, si dhe të ndihmojë në transicionin e gjyqësorit në veri të Kosovës”, ka thënë analisti politik Bodo Weber**

ka pasur nevojë për një mprehtësi më të madhe dhe përsheptim të ndjekjes së personave, për të cilët kanë mundur të nisin hetimet më herët. Pra, këtë e shoh si përsheptim të angazhimit të prokurorëve në vendosjen e njërit prej rasteve që mund të konsiderohen të mëdha.

**KD:** Kur nisi punën në Kosovë, EULEX-i premtoi rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sa janë përmbushur këto pritje?

**Weber:** Konsideroj se pritjet janë përmbushur vetëm pjesërisht. Dhe kjo është arsyeja kryesore për zhgënjimin e qytetarëve të Kosovës në EULEX, ani pse pritjet dhe shpresat kanë qenë të mëdha se do të bëjë më shumë.

**KD:** Po ashtu, ka munguar ndjekja e “peshqve të mëdhenj”. A mendoni se puna e EULEX-it shpesh është penguar edhe për shkak të ruajtjes së stabilitetit politik?

**Weber:** Në fakt, nga ajo që kemi parë ka indikacione të shumta të ndërhyrjeve në rastet e profilit të lartë nga Brukseli. Nëse kjo është e vërtetë, unë jam i sigurt se ndërhyrjet e tilla janë motivuar për të ruajtur stabilitetin politik në Kosovë.

## BE-ja dështoi ta ndreqë EULEX-in

**KD:** Ndërkohë, negociatat për vazhdimin e mandatit të EULEX-it janë duke vazhduar dhe pritjet janë që atij t'i zgjatet jeta në Kosovë. Cili do të duhej të ishte roli i misionit në periudhën e ardhshme?

**Weber:** Bashkimi Evropian ka pasur një mundësi të madhe para dy vjetësh për ta ndrequr mandatin e EULEX-it, kohën kur është planifikuar mandati aktual pas fillimit të dialogut. Por, për fat të keq, nuk ka pasur vullnet politik për ta bërë këtë. Mes zgjidhjes që ta ndreqë EULEX-in ose ta mbyllë atë, Bashkimi Evropian nuk e bëri asnjëherë, por pasoi një mandat i thyer dhe një transicion i rremë. Prandaj, më e mira që mund të presim nga ky mision është përfundimi i disa rasteve të profilit të lartë nga prokurorët dhe gjyqtarët e EULEX-it, si dhe të ndihmojë transicionin e gjyqësorit në veri të Kosovës.

**KD:** Por, a janë institucionet e Kosovës të gatshme t'i marrin të gjitha kompetencat nga EULEX-i dhe t'i trajtojnë rastet e krimeve të rënda?

**Weber:** Definitivisht jo. Të gjitha palët e dinin këtë, kur mandati i tanishëm i EULEX-it ishte vendosur në vitin 2014. Prokurorët e EULEX-it, të cilët i kanë trajtuar rastet gjatë dy vjetëve të kaluar, e dinë këtë më mirë sesa kolegët e tyre të brendshëm, kur është fjala për punën e bërë.

**KD:** Nën mandatin e EULEX-it ka qenë edhe trajtimi i krimeve të luftës. Si i vlerësoni rezultatet e misionit evropian në këtë aspekt?

**Weber:** Kur është fjala për krimet e luftës, EULEX-it i është dashur të merrej me problemet e njëjta siç i ka pasur Tribunali Ndërkombëtarë i Hagës për krimet në ish-Jugosllavi. Kështu që edhe rezultatet e arritura mbeten të përziera.

**KD:** Një rol të madh misioni e ka pasur edhe në shtrirjen e rendit dhe ligjit në veriun e Kosovës, i populluar me shumicë serbe. A shihni të jetë bërë ndonjë përmirësim atje, si rezultat i angazhimit të EULEX-it?

**Weber:** Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it në Gjykatën Themelore të Mitrovicës gjatë viteve të paktën kanë siguruar një nivel minimal të sundimit të ligjit. Por në përgjithësi, në veri situata vazhdon të jetë asisoj ku mbretëron mjedis i lirë sa i përket sundimit të rendit dhe ligji.

**KD:** Jetëgjatësia e EULEX-it është ndërlihur edhe për shkak të Gjykatës Speciale, e cila së shpejti pritët të nisë punën. Sa do të mund të japë kontribut EULEX-i pasi, siç dihet, institucioneve të Kosovës nuk u është besuar ndonjë rol veçmas kur është fjala për mbrojtjen e dëshmitarëve?

**Weber:** Themelimi i Gjykatës Speciale është justifikuar pjesërisht nga pamundësia për të mbrojtur dëshmitarët brenda Kosovës. Dhe kjo pa dyshim flet për "forcën" e institucioneve të Kosovës. Pra, ka një lidhje mandati i EULEX-it me punën e Gjykatës Speciale.

© KOHA Ditore